



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:211787

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855138

Ac.nr.6225/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar, Kujtim Pasuli dhe Dardan Kadolli-anëtarë, duke vendosur në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit Q(F)H nga fsh. Z... K.Klinë, me të autorizuar av. Rr.B nga Klina, ndaj të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike – KEDS-i, Sh.A me seli në .....,Prishtinë, me të autorizuar av.M.B, nga Prishtina, baza juridike kompensim i dëmit, vlera e kontestit 912 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.225/2017, të datës 08.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike – KEDS-i, Sh.A me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.225/2017, të datës 08.07.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, C.nr.225/2017, i datës 08.07.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.225/2017, të datës 08.07.2021, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET TËRËSISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditësit Q(F)H nga fsh. Z... K.Klinë, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike –KEDS-i, Sh.A me seli në .....,Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të paguaj shumat si në vijim: 1. Fitimi i munguar:

Për vitin 2017, vlera në shumë prej 228,05 euro (dyqind e njëzet e tetë euro, e pesë cent).

Për vitin 2018, vlera në shumë prej 228,05 euro (dyqind e njëzet e tetë euro, e pesë cent).

Për vitin 2019, vlera në shumë prej 228,05 euro (dyqind e njëzet e tetë euro, e pesë cent).

Për vitin 2020 vlera në shumë prej 228,05 euro (dyqind e njëzet e tetë euro, e pesë cent). Ashtu vlera e tërësishme përfshinë vlerën në shumë prej 912,20.00 euro, (nëntëqind e dymbëdhjetë euro, e njëzet cent) të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale vlera në shumë prej 966,00 euro (nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro) nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit apo aktgjykimi të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Paditësi nuk ka dhënë përgjigje në ankesën e të paditurit, edhe pse të njëjtit ankesa iu është dorëzuar.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës për kompensim dëmi.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj si të bazuar duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimimit.

Ndërsa në arsyetim ka theksuar se: gjykata për të vërtetuar faktin relevant kontestues lidhur me lartësinë e kërkesëpadiës që konsiston për demin me fitimin e humbur bëri edhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia e agronomisë nga eksperti Ing L.D, në bazë të secilës u vërtetuara lartësia e kërkesëpadiës që konsiston në fitimin e humbur për demin e shkaktuar nga e paditura për vitet 2017, 2018, 2019, 2020. Në llogarinë për vlerësimin e prodhimit, është marrë për bazë lëvrimi i tokës, pijatimi, trinimi (përgatitja e tokës për mbjelle), sasia farës, kositja, dhe lidhja e duajve me mekanizëm, në bazë të se cilës gjykata kësaj ekspertize ja fali pjesërisht besimin sa i përket fitimit të humbur, ngase e njëjta është kryer me profesionalizëm, duke vlerësuar se përmban elemente të nevojshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale duke përfshirë edhe arsyet e mjaftueshëm për vërtetimin e fakteve vendimtare, ndërkaq sa u përket shpenzimeve materiale të prezantuara gjykata i konsideron si të paargumentuara (të supozuara), me që të njëjtat absorbohen në produktin final-duaj të lidhur të jonxhës, te kategorizuara si fitim i humbur andaj kësaj pjese të mendimit dhe konstatimit profesional gjykata nuk ja fali besimin. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e palës se paditur të cilat konsistojnë në kontestimin e pjesërishtëm të kërkesëpadiës, mirëpo të njëjtat si të paqëndrueshme nuk i pranoi me arsyetimin se konform dispozitave ligjorë nenit 136 të LMD-së “1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Për ekzistimin e përgjegjësisë në bazë të fajësisë duhet të ekzistoj veprimi dëmshëm, dëmi, dhe lidhja shkakësore si kushte të përgjithshme për demin e shkaktuar, si dhe faji si kusht veçantë. Lidhja shkakësore si kusht i përgjithshëm paraqet asi raporti ndërmjetë veprimit të dëmshëm dhe dëmit, ku veprimi dëmshëm paraqitet si shkas, e dëmi si pasojë i atij veprimi. Andaj në rastin konkret në këtë çështje kontestimore dëmi i shkaktuar nga e paditura është konstatuar edhe në procesverbalin e inspektoratit komunal të Klinës nr ..., i cili dëm pjesërisht nuk kontestohet as nga e paditura. Ndërkaq veprimi i të paditurës përmes të cilit është shkaktuar dëmi paditësit vërtetohet edhe në lejen e punës dhe punët e kryera të hartuara nga e paditura me datë 14.06.2017, përkatësisht nga punë kryerësit e saj- punëtorët A.K dhe S.Sh. Ndërkaq dispozitat ligjore të nenit 137 të LMD-së përcaktojnë “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. E që në rastin konkret kemi të bëjmë me fitimin e humbur të pasurisë që paraqet demin real nënkupton fitimin evident në të ardhmen të cilin do ta realizonte

i dëmtuari këtu paditësi sikurse të mos paraqitej dëmtimi i paluajtshmerisë së paditësit në sipërfaqen prej 6 ari gjë që me pas i dëmtuari këtu paditësi ka qenë i detyruar për shkak të dëmtimit të pjesërishtëm nga e paditura të njëjtën sipërfaqe të mbjellur me jonxhë ta prishë në tërësi dhe ta mbjellë me kultura tjera lavërtare. Gjykata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenit 173 të LMD-së, të cilat dispozita ligjore përcaktojnë 1. “I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur, ndërsa paragrafi 3 i po të njëjtit ligj përcakton “3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin “e që në rastin konkret kemi të bëjmë me fitimin e humbur për vitet vijuese si 2017, 2018,2019,2020, fitim apo dobi të cilën pala paditëse do ta kishte realizuar sikurse e njëjta të mos ishte shkaktuar nga pala e paditur, e cila gjë është vërtetuar edhe përmes ekspertizës së lartcekur. Gjykata përfundon se i padituri ka qenë i obliguar që të bëjë një kompensim të dëmit të shkaktuar, sepse punëtoret e së njëjtës me rastin e rregullimin të rrjetit elektrik kanë ndikuar në dëmtimin-prishjen e pronës së palës së paditur, e që si rezultat i këtyre pengesave paditësi ka pësuar dëm në formë të fitimit të humbur, ngase i është bllokuar edhe fitim në një periudhë të gjatë kohore, të cilin fitim apo dobi do ta kishte realizuar sikurse të mos kishte e ndodhur e njëjta. Gjykata u bazua po ashtu në dispozitat ligjor të nenit 2.1 LPK-së në të cilat dispozita përcaktohet “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”. Andaj nga të dhënat në shkresat e lëndës dhe nga ekspertiza e punuar në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundimin se fitimi i munguar tek paditësi, është në shumën prej 912,20.00 euro. Në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 452 par.1 dhe 463 par. 1 të LPK-së, u vendos lidhur me shpenzimet procedurale, dhe atë ketë duke konkretizuar me 5 seanca gjyqësore shpenzime të avokatit 675 euro, shpenzimet eksperteve 270 euro, dhe taksa gjyqësore 21 euro, e që gjithsejtë përbejnë shumën 966,00 euro. Andaj nga arsyet e theksuara me lartë konform dispozitave ligjore të lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedhë se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182.2 pika n) e LPK-së, për shkak se aktgjykimi nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk do të mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktgjykimit, në të janë treguar arsyet për faktet vendimtare dhe se për faktet nuk ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit.

Pretendimet ankimore se gjykata ka dështuar që ekspertit ti jap detyra të qarta nuk qëndrojnë, sepse eksperti i agronomisë ing.L.D në mënyrë profesionale ka sqaruar se e paditura i ka shkaktuar dëmin e pretenduar paditësit, llojin e dëmit dhe kohëzgjatjen, e që me të drejtë gjykata e shkallës së parë ia ka falë besimin e plotë ekspertizës së këtij eksperti.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), dhe neni 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.6225/21, me datë 19.06.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari  
Fatmir Baloku d.v